

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-570 W Pele Elástica + Fibras

VESHJE ELASTIKE DHE ME FIBRA PËR HIDROIZOLIM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras, është një veshje ujore, me bazë stireni-akriliku dhe fibra. Pas tharjes, kthehet në një shtresë elastike-plastike pa ndryshime, me veti për mbylljen e plasaritjeve edhe në temperatura të ulëta.

PËRDORIMET

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Trafik këmbësorësh - i vizitueshëm.
- Vepron për mbylljen e plasaritjeve, për shkak të elasticitetit të lartë të saj.
- Lejon përhapjen e avullit të ujit.
- Rezistencë e mirë ndaj përhapjes së CO₂ (parandalim i karbonimit).

- Ndërkapje e mirë mbi materiale të ndryshme.
- Lejon aplikim në trashësi të madhe shtrese.
- Qëndrueshmëri e lartë ndaj ekspozimit në kushtet e mjedisit.
- Ujor (pa tretës).

MIRATIME / STANDARDE

Veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit sipas EN 1504-2:2004, Deklaratë Performance 94624696, certifikuar nga organi i certifikimit të kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 0866, certifikatë pajtueshmërie nga kontrolli i prodhimit në fabrikë 0866-CPR-2008/CE.0097, mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Solucion ujor me bazë rrëshirash stireni-akriliku.	
Ambalazhi	Sikagard® 570 W Pele Elástica® + Fibras:	4 kg, 5 kg, 18 kg dhe 20 kg
	Sikagard®-551 S Primer:	5 l dhe 25 l
	Sikagard®-552 W Aquaprimer:	5 l dhe 25 l
	Ju lutemi lexoni skadat teknike të prajmerave.	
Ngjyra	E bardhë, gri, ngjyrë tulle	
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit.	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur, të padëmtuar dhe në kushte të thata. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	~ 1,25 kg/dm ³ (në +23 °C).	
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~ 63%	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	≥ 1,0 (0,7) N/mm ²	(EN 1542)
Aftësia e ngushtimit të plasaritjeve	kategoria A5	(EN 1062-7)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Sipërfaqe minerale:

Prajmer	1 x Sikagard®-551 S Primer (nënshtresa kompakte)
Prajmer	1 x Sikagard®-552 W Aquaprimer (nënshtresa poroze)
Veshja*	2 - 3 x Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras

Membrana bituminoze:

Prajmer	1 x Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras i holluar me 10% ujë
Veshja*	2 - 3 x Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras

Sipërfaqe metalike:

Prajmer	1 x SikaCor® EG-1
Veshja*	2 - 3 x Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras

*Numri i veshjeve ndryshon sipas cilësisë së nënshtresës dhe nevojës për hidroizolim.

Veshje pikësore:

Rekomandohet aplikimi i një veshjeje shtesë Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras mbi tegelat, lidhjet dhe mbivendosjet e materialit bazë përpara veshjes së plotë.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi / Prodhimi / Doza (PRINTIM i një vije të vetme)

Produkti	Konsumimi
Sikagard®-570 W Pele Elástica + Fibras i holluar me 10% ujë:	~ 0,7 kg/m ² /veshje - 0,9 kg/m ² /veshje
Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras:	
Mbi tarraca/çati*:	~ 1,0 kg/m ² /veshje
Mbi sipërfaqe vertikale**:	~ 0,5 kg/m ² /veshje

*2 ose 3 veshje Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras

** 2 veshje Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras

Temperatura e mjedisit	Min.: +5 °C / Max.: +35 °C
Lagështia relative e ajrit	Max. 80% lagështi relative
Temperatura e nënshtresës	Min.: +5 °C / Max.: +35 °C
Pika e vesës	Kujdes kondensimin! Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose çngjyrosjes mbi sipërfaqen përfundimtare të dyshemesë.
Përgatitja e nënshtresës	Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa ndotës si pislleqe, vajra, graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj. Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë për provë.
Produkti i aplikuar gati për përdorim	I thatë në prekje ~ 6 orë (në +23 °C) I thatë ~ 24 orë (në +23 °C)
	Shpejtësia e tharjes mund të vonojë nëse ka temperaturë të ulët dhe/ose lagështi relative të lartë.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa ndotës si p.sh vaj, graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj.

Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

Mbushni plasaritjet, hapësirat dhe poret me Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras. Nëse nevojitet aplikoni një shtresë të hollë llaçi nivelues ose izoloni poret me Sika® MonoTop®-620, Icoment® Massa, Sika® Rep Cosmetic, etj. Koha e tharjes së shtresës së hollë niveluese të llaçit me bazë çimentoje duhet të jetë të paktën 4 ditë përpara nisjes së lyerjes.

Beton ose llaç:

- Duhet të jetë i qëndrueshëm, pa pislleqe dhe graso, pa rrjedhje, vaj të ndenjtur dhe grimca të shpërbëra.
- Metoda të përshtatshme përgatitjeje: pastrim me avull, rrymë uji (me presion të lartë mbi sipërfaqet e betonit) ose rrymë ajri (vetëm mbi nënshtresa betoni).
- Betoni ose llaçi i ri duhet të jenë të paktën 28 ditësh.
- Mbi betonin ose llaçin e lyer duhet të testohet ndërkapja e bojës ekzistuese (ndërkapje mesatare > 0,8 N/mm², pa vlera nën 0,5 N/mm²):

Ndërkapje e pamjaftueshme e bojës së vjetër: hiqni të gjithë bojën e vjetër me metodat e përshtatshme, duke lënë një bazë mjaftueshëm të fortë dhe të qëndrueshme, në mënyrë që të mund të lyhet siç tregohet më sipër.

Ndërkapje e mjaftueshme e bojës së vjetër: pastroni me kujdes të gjithë sipërfaqen me spërkatje të bollshme avulli ose uji. Përdorni prajmerin Sikagard®-552 W Aquaprimer.

Membrana bituminoze:

- Hapni pjesët që mund të jenë fryrë dhe ngrini skajet.
- Lejoni tharjen, pastrimin dhe pas mbushjes ngjeshni skajet. Plasaritjet e bitumit duhet të mbushen me Sikagard®-570 W Pele Elástica® të holluar.

Sipërfaqe metalike:

- Nuk duhet të kenë ndotje, graso ose vaj.
- Metoda të përshtatshme përgatitjeje: rrymë abrazive, heqje e grasos me lagje nga një tretës, shpëlarje me ujë dhe detergjent ose me rrymë avulli.

PËRZIERJA

Sikagard® 570 W Pele Elástica® + Fibras është gati për përdorim.

Përzieni plotësisht produktin përpara aplikimit.

Sikagard®-570 W Pele Elástica® mund të aplikohet me furçë, rul ose spërkatje pa ajër.

Hollimi pakëson qëndrueshmërinë e Sikagard®-570 W Pele Elástica®.

APLIKIMI

Sikagard® 570 W Pele Elástica® + Fibras mund të aplikohet me furçë, rul ose spërkatje pa ajër.

Hollimi pakëson qëndrueshmërinë e Sikagard® 570 W Pele Elástica® + Fibras.

Aplikoni tërthorazi veshjet vijuese, pasi të jetë tharë plotësisht e mëparshmjja. (ndryshon sipas kushteve të motit).

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit.

Materiali i ngurtësuar dhe/ose i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Të mos përdoret mbi nënshtresa në kontakt të përhershëm me ujin, nënshtresa të saturuara ose subjekt i kondensimit.
- Sikagard®-570 W Pele Elástica® është bojë përfundimtare, nuk nevojitet veshje tjetër.
- Tek fugat, plasaritjet ose tegelat e nënshtresës, duhet të aplikohet fibër qelqi për të mbyllur hapësirën. Fibrat e qelqit nuk duhet të ngjiten tek nënshtresa.
- Mos vendosni objekte mbi veshjen të cilat mund të sulmojnë fizikisht produktin e aplikuar.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja max. e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / i lloji WB) është 140 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja max. e Sikagard®-570 W Pele Elástica® + Fibras është < 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikagard®-570 W Pele Elástica + Fibras
Maj 2019, Botimi 01.01
020915106000000001

Sikagard-570WPeleElstica+Fibras-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf